VENDIM
Nr. 37, datë 11.2.2021

MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË FTL SHA, PËR SHTYRJEN E HYRJES NË FUQI TË VENDIMIT NR. 202, DATË 2.12.2020, PËR MIRATIMIN E "RREGULLORES PËR PROCEDURAT E SHITJES SË TEPRICAVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË TREGUN E PARREGULLUAR PËR SHOQËRINË PUBLIKE TË FURNIZIMIT"

Në mbështetje të neneve 16 dhe 19, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 104, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të nenit 11, pikat 2 dhe 3, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 244, datë 30.3.2016, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", të ndryshuar, dhe të nenit 15 të "Rregullores për Organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.2.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 25/3 prot., datë 802.2021, të drejtorive teknike,

konstatoi se:

- Shoqëria "Furnizuesi i Tregut të Lirë" (FTL sh.a.), me shkresën nr. 320/1 prot., datë 4.2.2021, kërkoi nga ana e ERE-s shtyrjen e datës së hyrjes në fuqi të "Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 202, datë 2.12.2020, deri në fund të muajit prill 2021.
- Me vendimin e Bordit të ERE-s, të sipërcituar, u vendos miratimi i "Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit në tregun e lirë, FTL sh.a.", hyrja në fuqi e së cilës u vendos pas botimit në Fletoren Zyrtare.
- Në shkresën e përcjellë nga FTL sh.a., me nr. 320/1 prot., datë 4.2.2021, shoqëria bën me dije se ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për realizimin e ndryshimit/zhvillimit në platformën IT *online* të blerjes së energjisë, me qëllim përdorimin e saj edhe për procedurat e shitjes. FTL sh.a. ndër të tjera në shkresë parashtron se është lidhur kontrata e shërbimit në datën 11 janar 2021, me subjektin fitues i cili do të bëjë ndërhyrjet në platformën IT *online*, si dhe në kontratë është përcaktuar se afati për implementimin e ndryshimeve/të zhvillimeve të platformës është 65 (gjashtëdhjetë e pesë) ditë nga data e lidhjes së kontratës.
- Nga analiza e afateve të raportuara nga vetë shoqëria FTL sh.a. në shkresën e sipërcituar, rezulton se hyrja në fuqi e "Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 202, datë 2.12.2020, nuk mund të shtyhet deri në fund të muajit prill, siç shoqëria ka kërkuar, por deri më 31 mars 2021.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen e datës së hyrjes në fuqi të "Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 202, datë 2.12.2020, deri më 31 mars 2021.
2. Për periudhën tranzitore, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, FTL sh.a., për qëllim të procedurës së shitjes së tepricave të energjisë elektrike, të përdorë "Rregullat e përgjithshme të

organizimit të aktivitetit tregtar nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a.", të miratuar me vendimin nr. 5233/1, datë 12.6.2019, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit.

3. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqërinë FTL sh.a. dhe palët e interesit të përfshira në dhënien e opinioneve për draftin e "Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit", Shoqatën Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti